

**AKT THEMELIMI**  
**Për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar**  
**“ZABEL” SH.P.K.**

Sot, më datën 06.11.2023, **Znj. Elsa Kepi** e lindur në Krujë, Shqipëri më datë 12 Prill 1997 mbajtëse e letërnjoftimit elektronik me numër personal J75412055M, banuese në Durres, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar vendosi të themelojë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “ZABEL” Sh. P. K. si më poshtë vijon

**Neni 1**

Personi fizik i sipërpërmendur, me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar, krijon shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar (Sh.P.K.) me emërtimin “ZABEL” shpk.

Ortak i kësaj shoqërie është **Znj.Elsa Kepi**.

Administratore e kësaj shoqërie caktohet **Znj.Elsa Kepi**, shtetase shqiptare, lindur ne Shqipëri me 12 Prill 1997, e pajisur me NID nr.J75412055M. Znj.Kepi emerohet administratore e shoqërisë për një periudhë 5 vjecare.

Shoqëria ka të drejtë të krijojë filiale të saja brenda dhe jashtë vendit në çdo kohë që do të vlerësohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

**Neni 2**

Shoqëria “ZABEL” shpk gëzon statusin juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Sh.P.K.”. Veprimtaria e saj do të zhvillohet sipas dispozitave të kësaj kontrate, statutit të saj dhe legjislacionit në fuqi.

Selia e shoqërisë “ZABEL” SH.P.K. është: **Durres,Lagjja 4, Rruga Fetah Bllaca, Pallati 1133, Kati i tretë.**

Statuti i shoqërisë i bashkangjitet këtij akti themelimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Shoqëria ka vulën e saj me logon dhe të dhënat të përcaktuara.

**Neni 3**

Veprimtaria e shoqërisë si person juridik fillon me aprovimin e krijimit të saj nga organet kompetente të shtetit dhe do të vazhdojë për një periudhë kohe pa afat të përcaktuar.

**Neni 4**

Shoqëria do të kryejë aktivitetet me objekt:

- Ndertim i sallave për bagetite;
- Transport mallrash brenda dhe jashtë vendit për llogari të vetë dhe të tjerë;
- Tregëtim me shumicë dhe pakicë të mallrave dhe shërbimeve;
- Dhenie me qira. Vlerësim të pasurive të paluajtshme,etj.

**Neni 5**

Kapitali i shoqërisë është 10.000 Leke. Kapitali i shoqërisë ndahet në një numër kuotaesh në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri ku çdo ortak zotëron një kuota të vetme në shoqëri, kuota keto të shlyera si më poshtë:



- **Znj.Elsa Kepi** zotëruese e një kuote me vlerë të përgjithshme 10.000 leke që përbën 100% të kapitalit të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme ose te paluajtshme apo te drejta). Ortaket pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

#### **Neni 6**

Fitimi neto nga aktiviteti i kësaj shoqërie i përket ortakëve të saj.

#### **Neni 7**

Për detyrimet që do të krijohen ndaj personave të tretë gjatë aktivitetit të kësaj shoqërie do të përgjigjet vetë shoqëria deri në kufirin maksimal të kapitalit të saj.

#### **Neni 8**

Marrëdhëniet e punës në shoqëri dhe në filialet e saj rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

#### **Neni 9**

Dispozita të hollësishme mbi organizimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj. Themeluesit e kësaj shoqërie, pasi e lexuan me vëmendje këtë akt themelimi dhe e gjetën në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me vullnetin e tyre, e firmosën pa vërejtje.

### **ORTAKU I VETEM I SHOQERISE**

**ELSA KEPI**

